

GJYKATA E QARKUT PEJË

Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo
OKRUŽNI SUD PEĆ

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

Kancelarija Specijalnog Tužilaštva Republike Kosovo 09 2010 15 39

MARRË NË DOREZIM
PRIMLJEJO

Prishtinë 8 shtator 2010

PPS Nr: 18/09

Gjykatës së Qarkut në Pejë

Në pajtim me Nenet 304 (1) dhe 305 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Unë, prokurori i nënshkruar, lëshoj këtë:

Aktakuzë

Kundër

Emri	<u>Vukmir</u>
Mbiemri	<u>CVETKOVIĆ</u>
Emri i babait	[REDACTED]
Ditëlindja	12/08/1969
Vendlindja	Klinë, Pejë
Gjinia	Mashkull
Adresa	Rr. Boro Milotović, nr. 4 Klinë
Kombësia	Serb
Nënshtetësia	Kosovar

Për veprën e mëposhtme penale:

Krime lufte kundër popullatës civile të parashikuara dhe të dënuara me Nenin 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë (KPRFSJ), momentalisht e penalizuar sipas Neneve 23 dhe 121 (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), ne kundërshtim me nenin 3 të i përbashkët përkatër konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe nenit 1 dhe 17 të Protokollit II te 8 qershorit 1977 si shtesë e 1949 të Konventës së Gjenevës të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar që kanë qenë në fuqi gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjithmonë në lidhje me akuzën e tanishme, i akuzuari, duke vepruar së bashku me anëtarët e tjerë të policisë serbe dhe i veshur me uniformë, ka marrë pjesë në operacionet luftarake në qytetin e Klinës dhe që kanë përvirë zhvendosjen e popullatës shqiptare civile jashtë Klinës duke i urdhëruar ata që ti lëshonin shtëpitë e tyre dhe të largoheshin nga fshati dhe duke ua vënë flakën shtëpive të tyre; Në Klinë në fund të marsit 1999.

BAZAT PËR AKTAKUZË DHE PËRMBLEDHJA E PROVAVE

Hetimet për këtë rast fillojnë nga ankesat të dorëzuara në shtator të vitit 2005 kundër z. Cvetković , atëherë një policë i Policisë së Kosovës nga disa qytetarë të Klinës, duke përfshirë S. Si . Si . (13.02.1958) A. T. dhe S. S. (19.08.1966).

dëshmitë e mbledhura gjatë hetimeve në këto ankesa ia mundësuan prokurorit që të konkludojë se më 27 ose më 28 mars 1999 Vukmir Cvetković mori pjesë së bashku me anëtarët e tjerë të policisë serbe në operacione ushtarake në qytetin e Klinës. këto operacione përbënин zhvendosjen e popullatës shqiptare civile jashtë Klinës duke i urdhëruar ata që ti lëshonin shtëpitë e tyre dhe të largoheshin nga fshati dhe duke ua vënë flakën shtëpive të tyre. Si rezultat i operacioneve të tillë disa familje shqiptare u larguan nga qyteti dhe disa shtëpi të shqiptarëve u dogjën.

Veçanërisht S. S. (13.02.1958) dëshmoi para policisë së UNMIK-ut dhe prokurorit të nënshkruar se pasi që e kishin përzënë policia serbe nga shtëpia e tij në Klinë, ai e kishte parë z. Cvetković duke ua vënë flakën shtëpive të N. S. dhe të K. dhe Z. Q. duke përdorë hedhësin e flakës.

Që z. Cvetković ia vuri flakën shtëpisë së Z. f. Q. me hedhësin e flakës është gjithashtu dëshmi e L. Tomajt dhe e Pren. Simonajt që ia dhanë deklaratat policisë së UNMIK-ut.

S. S. (19.08.1966) dëshmoi para prokurorit të nënshkruar që z. Cvetković , megjithëse i uniformuar dhe i armatosur nuk ia drejtoi atij pushkën automatike AK-47. ishte një tjetër polic serb i paidentifikuar që e bëri këtë gjë. Dhe që e shoqëronte z. Cvetković . Në ndërkohë z. Cvetković qëndronte pranë ushtarit që e mbante pushkën e tij A-47.

Të tre dëshmitarët që e kanë njojur z. Cvetković si bashkëfshatar për pjesën më të madhe të jetës së tyre treguan se ata e kanë paraqitur rastin vetëm më 2005 sepse i pandehuri u ktheye vetëm më 2005 në qytet që të punonte si polic. Pamja e të pandehurit në fshat i veshur me uniform të politit bëri që ata pa u vonuar ta paraqitnin atë për ato që kishte bërë më 1999.

Gjatë ekzaminimit të tij nga prokurori i nënshkruar më 17 gusht 2010 dhe në prezencën e avokatit të tij mbrojtës që ai e kishte zgjedhur, z. Cvetković konfirmoi se në mars 1999 ai ishte polic rezervë që ishte thirrur në detyrë pas fillimit të fushatës bombarduese të NATO-s (24 mars 1999). ai gjithashtu tha se ishte i pajisur me uniformë policore të cilën ai e kishte bartur kur ishte në detyrë dhe një pushkë AK-47. z. Cvetković gjithashtu tha se në ditën në fjalë rrugës kur po kthehej nga puna ai kaloi përmes qendrës së Klinës dhe i pa një numër familjesh shqiptare që ishin përzënë nga qyteti. Ai i njobhu disa prej tyre duke përfshirë të afërmët e familjes Simonaj . z. Cvetković më në fund tha se ai i njeh personalisht të dy S. S. dhe Endjel Tomaj dhe se ai gjithmonë kishte pasur me ta raporte të mira fqinjësore.

Dëshmia e përmendor më sipër tregon dyshimin e bazuar mirë që z. Cvetković gjatë fundit të marsit 1999 morri pjesë në operacione ushtarake që kishin për qëllim përzënien e popullatës shqiptare civile nga Kлина. Ai mori pjesë në kërcënimin e civilëve për ti lëshuar shtëpitë e tyre dhe ua vuri flakën të paktën dy shtëpive.

Veprime të këtilla e përbënë veprën Krime luftë kundër popullatës civile duke pasur para sysht që këto veprime shkelin qartësisht dispozitat e neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ (sjellja e njëjtë

momentalisht të penalizuara sipas neneve 23 dhe 121 par. 2 të KPK) dhe e shkelin nenin 3 të i përbashkët për katër konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe nenit 1 dhe 17 të Protokollit II te 8 qershorit 1977 si shtesë e 1949 të Konventës së Gjenevës të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar që kanë qenë në fuqi gjatë kohës së konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë.

Ekziston një praktike ligjore e brendshme dhe ndërkombëtare që thotë se në Mars 1999 zhvillohej një konflikt i brendshëm i armatosur në mes të forcave serbe dhe të UÇK-së në territorin e Kosovës. Sjellja e të pandehurit, siç u pa më lart është pjesë e një operacioni më të gjërë e kryer nga forcat serbe (me gjasë policia serbe) në kontekstin e këtij konflikti të armatosur (në mes të sjelljes dhe të konfliktit). Më në fund mund të ketë pak dyshim se viktimat e veprimeve të z. Cvetković ishin civilë që nuk merrnin pjesë në asnjë mënyrë në armiqësi.

PROPOZIMI PËR GJYKIM

Prokurori propozon që të caktohet gjykimi kryesor i kësaj çështjeje dhe që ai të mbahet në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

Prokurori kërkon që personat e mëposhtëm të thirren për të marrë pjesë:

- prokurori i nënshkruar
- i pandehuri z. Cvetković dhe avokati i tij mbrojtës z. Ljubomir Pantović,
- të dëmtuarit S. [REDACTED] (13.02.1958), E. [REDACTED] T. [REDACTED], P. [REDACTED] S. [REDACTED] S. [REDACTED]
- (19. 8.1966), Z. [REDACTED] Q. [REDACTED], K. [REDACTED] C. [REDACTED] dhe N. [REDACTED] S. [REDACTED].

Prokurori propozon se në gjykimin kryesor të dëgjohen dëshmitarët e mëposhtëm:

- S. [REDACTED] S. [REDACTED] (13.02.1958)
- S. [REDACTED] S. [REDACTED] (19.8.1966),
- E. [REDACTED] T. [REDACTED]
- P. [REDACTED] S. [REDACTED]

Prokurori gjithashtu propozon që të pranohen dokumentet e mëposhtme:

- Fotografitë e shtëpive që pretendohet se janë djegur nga i pandehuri
- Dosja e z. Cvetković si polic i Policisë së Kosovës.
- Raportet hetuese të policisë së UNMIK-ut
- Deklarata e të akuzuarit

PROPOZIM PËR PARABURGIMIN E TË PANDEHURIT

I pandehuri pasi që u ekstradua nga Norvegjia u arrestua në Kosovë më 13 korrik 2010. Pas dëgjimit së seancës së mbajtur nga gjyqtari i procedurës paraprake në Pejë, të akuzuarit iu shqiptua paraburgimi prej një muaji. Një kolegi prej tre gjyqtarësh i gjykatës së njëjtë rrjedhimisht ia vazhdoi paraburgimin për dy muaj të tjera kundër të akuzuarit.

Prokurori i nënshkruar beson se të gjitha rrethanat e treguara në kërkesat e mëparshme për paraburgim (veçanërisht duke marrë para sysh rrezikun e arratisjes pasi që i pandehuri ka iku-

nga Kosova dhe është strehuar në Norvegji ku u arrestua) janë ende të pranishme dhe paraburgimi është i nevojshëm për ta siguruar praninë e të pandehurit në gjykim.

Për arsyet e lartpërmendura prokurori me respekt kërkon që gjyqtari për konfirmim urdhëron që masa e paraburgimit kundër të pandehurit të vazhdojë të qëndrojë.

